

LIGJ
Nr. 9716, datë 16.4.2007

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8438, DATË 28.12.1998 “PËR TATIMIN
MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Shkronja “h” e nenit 4 ndryshohet si më poshtë:

“h) të ardhurat e realizuara nga shërbimet e kryera në territorin e Republikës së Shqipërisë nga një person jorezident.”.

Neni 2

Neni 11 "Kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme" riformulohet si më poshtë:

“Neni 11

Kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme

1. Kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, tokë e ndërtesa, tatohet me 10 për qind të fitimeve kapitale të realizuara. Ky paragraf nuk zbatohet në rastet e shkëmbimit të së drejtës së pronësisë mbi tokën me të drejtën e pronësisë mbi ndërtesën e ndërtuar mbi tokë. Në këtë rast tatimi i të ardhurave kryhet sipas procedurës së dhënë në paragrafin 2 të këtij ligji

2. Tatimi paguhet nga individit që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit të pasurive të mësipërme, në përputhje me aktet ligjore. Pasuria e paluajtshme nuk regjistrohet, pa provuar pagimin e detyrimit pranë zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

3. Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme janë të detyruara që, brenda 10 ditëve, të transferojnë për llogari të administratës tatimore tatimin e paguar, sipas parashikimeve të këtij neni.”.

Neni 3

Shkronja “d” e nenit 15 ndryshohet si më poshtë:

“d) për rastet e shkeljeve të dispozitave të parashikuara në shkronjën “e” të nenit 14, punëdhënësi gjohet me 10 për qind të shumës së tatimit të mbajtur në burim, të deklaruar me vonesë, por jo më pak se 10 mijë lekë.”.

Neni 4

Në fund të nenit 20 "Shpenzime të njohura", shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

“Për veprimtaritë e ndërtimit dhe shitjes së ndërtesave me destinacion për strehim, veprimtari prodhuese, veprimtari tregtare ose shërbimi, njihet si shpenzim i zbritshëm edhe vlera e truallit të vënë në dispozicion nga pronari i tokës, sipas kontratave të këmbimit të truallit me sipërfaqe ndërtimi. Metodika e përcaktimit të vlerës së truallit për m² miratohet nga Këshilli i Ministrave dhe bazohet në koston minimale fiskale të ndërtimit, sipas qyteteve apo zonave brenda qyteteve.

Për veprimtaritë e ndërtimit dhe shitjes së ndërtesave me destinacion për strehim, veprimtari prodhuese, veprimtari tregtare ose shërbimi, në të ardhurat e tatueshme të investitorit llogariten edhe të ardhurat që i korrespondojnë pjesës së sipërfaqes së ndërtimit që përfitojnë pronarët e truallit për rastet e kontratave të këmbimit truall-sipërfaqe ndërtimi. Vlerësimi i të ardhurave për pjesën e pronarit të truallit bëhet në të njëjtën mënyrë si për pjesën e të ardhurave të realizuara nga investitori dhe ai bazohet në metodikën e miratuar nga Këshilli i Ministrave lidhur me fitimin minimal fiskal.

Për ndërtimet e ulëta vetjake, për të cilat jepet leje ndërtimi nga komunat e bashkitë dhe që ndërtohen me individë të peregjistruar pranë organeve të administratës tatimore, zbatohen të njëjtat dispozita që rregullojnë pagimin e kontributit të sigurimeve shoqërore edhe në shoqëritë ndërtuese të regjistruara. Komunat e bashkitë që japin lejen, ngarkohen të vjelin e të transferojnë kontributet, sipas përcaktimeve të dhëna në udhëzimin e Ministrit të Financave.”.

Neni 5

Kreu III/a “Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin” dhe nenet 32/1, 32/2, 32/3, 32/4, 32/5, 32/6, 32/7 dhe 32/8 të këtij kreu shfuqizohen.

Neni 6

Dispozita kalimtare

Neni 2, që ndryshon nenin 11 të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 dhe neni 4, që ndryshon nenin 20 të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998, fillojnë të zbatohen më 1 janar 2008.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi më 1 korrik 2007.

**Shpallur me dekretin nr.5291, datë 8.5.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

